VENDIM
Nr. 509, datë 10.6.2015

PËR NJË RISHPËRNDARJE FONDESH, NDËRMJET PROGRAMEVE TË GRUPIT 87, NË PLANIN E INVESTIMEVE TË MIRATUAR PËR VITIN 2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a", të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 17, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve për shpenzime kapitale, ndërmjet programeve brenda buxhetit të vitit 2015, të miratuar për grupin 87, si më poshtë vijon:

a) Në programin 01140, "Shërbime për shoqërinë e informacionit", në planin e buxhetit të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE), në zërin "Shpenzime kapitale", përveç fondit 400 000 (katërqind mijë) lekë, shtohet fondi prej 11 400 000 (njëmbëdhjetë milionë e katërqind mijë) lekësh për financimin e projektit të rikonstruksionit të godinës së ish-INIMA-s;

b) Në programin 01140, "Shërbime për shoqërinë e informacionit", në planin e buxhetit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT), në zërin "Shpenzime kapitale", pakësohet fondi prej 7 400 000 (shtatë milionë e katërqind mijë) lekësh;

c) Në programin 01140, "Shërbime për shoqërinë e informacionit", në planin e buxhetit të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), në zërin "Shpenzime kapitale", pakësohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh;

ç) Në programin 01510, "Shërbime për teknologjinë dhe inovacionin", në planin e buxhetit të Agjencisë Kombëtare për Teknologjinë dhe Inovacionin (AKTI), në zërin "Shpenzime kapitale", pakësohet fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh.

2. Fondi prej 11 800 000 (njëmbëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekësh, sipas shkronjës "a", të pikës 1, të këtij vendimi, të përdoret për rikonstruksionin e ish-ambienteve të Ministrisë së Integrimit Evropian, në godinën ish-INIMA.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministria e Financave, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike dhe Agjencia Kombëtare për Teknologjinë dhe Inovacionin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama